

543 PIKËQASJA NË LIDHSHMËRI – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE

Fusha përmban pikëqasjen për formën e njësuar të emrit/titullit konvencional për tekstet ligjore dhe fetare, që është në lidhshmëri me pikëqasjen në fushën 2XX.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
543	Pikëqasja në lidhshmëri – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare	r
	a <i>Elementi hyrës</i>	nr
	t <i>Titulli konvencional</i>	nr
	3 <i>Numri i regjistrimit</i>	nr
	5 <i>Kodi për marrëdhënien</i>	nr
	9 <i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Nuk është i përcaktuar</i>
2	1	<i>Mënyra e shënimit të emrit emër i shënuar sipas shtetit ose emrave të tjerë gjeografik</i>
	2	<i>emër i shënuar sipas formës tjetër të emrit</i>

Vlera "1" e treguesit të dytë përdoret te emrat gjeografik nën juridiksion.

Vlera "2" e treguesit të dytë përdoret te emrat e kishës.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat a dhe t janë përshkruar tek fusha 243, ndërsa nënfusha 3, 5 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban emrin/titullin konvencional për tekstet ligjore dhe fetare, që është në lidhshmëri me pikëqasjen në fushën 2XX dhe është formuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

243 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE*

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

210	01	a Franca b Convention nationale
300	1□	a Asamblea Kombëtare Franceze midis revolucionit francez, e zgjedhur në vitin 1792, e shpërbërë më 28.10.1795 ; kishte fuqi legjislative, gjyqësore dhe ekzekutive.
543	□1	3 <nnn> 5z a Franca t Kushtetuta (1793)